


## Çfarë ndihme marrin familjet përkujdesëse?

- ☺ Kompensim në të holla për çdo fëmijë të strehuar;
- ☺ Mbështetje dhe trajnim nga Qendra e punëve sociale;
- ☺ Rrjet të mbështetjes të familjeve përkujdesëse.

Nëse keni menduar mirë dhe me përgjegjësi të plotë keni vendosur të përkujdeseni për një apo më shumë fëmijë, atëherë paraqituni në Qendrën më të afërt të punëve sociale.

Si përgjigje ndaj kërkesës suaj, personat përgjegjës të Qendrës së punëve sociale do t'ju vizitojnë e më pas do të ftoheni në trajnim për familje të ardhshme përkujdesëse.

**Sepse ÇDO FËMIJE I DUHET FAMILJE!**



Fushatë preventive për institucionalizimin e fëmijëve pa prindër dhe pa kujdes prindëror dhe për promovimin e formave alternative të përkujdesjes.



**ÇDO FËMIJE**



## Çështje familje përkujdesëse?

Përkujdesja në familje është një formë e organizuar e kujdesit<sup>1</sup> për fëmijë kur për ta nuk mund të kujdeset familja e tyre biologjike. Përkujdesja është e përkohshme - derisa nuk krijohen kushte në familjen biologjike apo derisa nuk merret vendim i përhershëm për këta fëmijë.

## Përse familje përkujdesëse?

Ka shumë arsye përse disa fëmijë nuk mund të rriten pranë prindërve të tyre: ndonjëherë për shkak të sëmundjes apo të vdekjes së prindërve, por, shpeshherë për shkak të lënies pas dore apo të keqtrajtimit.

Në rast se fëmija nuk mund të mbetet me familjen e tij biologjike atëherë familja përkujdesëse është zgjidhja më e mirë. Vetëm në familjen e vet fëmija ndien përkatësinë dhe mbështetjen dhe mësohet në jetë të organizuar shtëpiake.

Fëmijët pa prindër dhe pa kujdes prindëror strehohen në institucione. Por, asnjë institucion nuk mund ta zëvendësojë familjen. Çdo fëmijë ka të drejtë të rritet në familje.

## Cilët fëmijë kanë nevojë për familje përkujdesëse?

Për familje përkujdesëse kanë nevojë:

- ☺ Fëmijët të cilët i kanë humbur prindërit, pa marrë parasysh nëse ata kanë vdekur, i kanë braktisur apo për shkak të sëmundjes janë të penguar të kujdesen për ta;
- ☺ Fëmijët të cilët duhet të ndahen nga prindërit e tyre për shkak të lënies pas dore apo të keqtrajtimit.

<sup>1</sup> Në familje përkujdesëse mund të strehohet edhe person i moshuar apo i rritur që ka pengesa në zhvillim. Këtu bëhet fjalë vetëm për përkujdesjen e fëmijëve në familje.

## Kush mund të bëhet përkujdesës?

Nëse ndieni se mund të ofroni dashuri dhe nëse jeni të gatshëm përkohësisht të ndani shtëpinë tuaj me fëmijë i cili nuk mund të rritet pranë prindërve të vet biologjikë, atëherë mund të bëheni përkujdesës. Kuptohet, ekzistojnë kritere të cilat duhet t'i plotësoni, siç janë: kushtet e përshtatshme të banimit dhe të ardhurat, gjendja e mirë shëndetësore dhe qëndrimi pozitiv ndaj jetës. Por, para së gjithash familja përkujdesëse duhet të jetë e gatshme të ndajë kohën, energjinë dhe ngrohtësinë me fëmijën.

## Si mund të bëhesh përkujdesës?

Mund t'i drejtohesh Qendrës për punë sociale ku do të bëhet vlerësimi nëse i plotësoni kushtet për përkujdesës si dhe të kaloni trajnimin për përkujdesjen e fëmijëve. Personat përkatës të Qendrës së punëve sociale do t'ju ndjekin dhe përkrahin në realizimin e obligimeve tuaja. Si përkujdesës, do të bashkëpunoni me punëtorin social, me pedagogun, psikologun, prindërit apo tutorët e fëmijës që të gjithë së bashku të siguroni që fëmija të rritet në ambientin sa më të mirë të mundshëm.



# ÇDO FËM

# I DUHET FAMILJE!